

MONITOR

E PERJAVSHME VITI I VI I BOTIMIT NR. 41 (246) - 17 TETOR 2006 Çmimi 300 lekë, 3 EURO

BIZNES - EKONOMI - TREG

shitja

Sa kushton Banka Amerikane

FAQE 15

doganat

Zgjatet orari i punës deri në darkë

FAQE 23

shtrenjtimi i cigareve

Shqiptarët nuk e ulin konsumin

FAQE 32

ÇIMKAT E BIZNESIT!

sezoni i ri i televizioneve

SHTRENJTOHEN REKLAMAT

Në qoftë se mendoni se teknologjia mund të zgjidhë të gjitha problemet tuaja, atëherë nuk paskeni kuptuar asgjë, as për problemet tuaja, as për teknologjinë

Bruce Schneier

(criptographer, specialist i sigurisë së kompjuterave)

Nga Igli TASHI*

Solange GHERNAOUTI-HELIE**

Përdorimi i teknologjive të informacionit dhe sidomos i teknologjisë së Internetit nga ndërmarrjet dhe biznesi në përgjithësi, është shumë i përhapur në ditët e sotme. Kompjuteri konsiderohet tashmë si një mjet pune i domosdoshëm dhe si një vektor tepër i rëndësishëm përsa i përket rritjes së produktivitetit. Por pasojat, që mund të sjellë fenomeni i përdorimit të kësaj teknologjie, nuk janë totalisht të kuptuara mirë e aq më pak nën një kontroll rigoroz. Problematika e lidhur me fenomenin e përdorimit të Internetit është shumë e gjerë. Një nga aspektet e kësaj problematike që lidhet më shumë me biznesin, është dhe përdorimi i Internetit në vendin e punës, që në zhargon thirret 'cyberslacking'. Në fakt, fenomeni nuk është dhe aq i panjohur, pasi në thelb gjendemi para të njëjtit problem përsa i përket përdorimit të telefonit, apo të ndonjë mjeti tjetër komunikues jashtë kuadrit profesional. Megjithatë, teknologjitë e reja të informacionit sjellin një shkëputje të fortë të logjikës së mëparshme për shkak të specifikave që ato mbartin. Mund të përmendim këtu:

- dixhitalizimin e të dhënave: që sjell një pasiguri më të madhe, përsa i përket ruajtjes së informacionit. Kjo vjen nga fakti që informacioni numerik është tashmë totalisht i pavarur nga mbajtësi i tij (letër, bandë manjetike, disketë etj.);
- ndjekjen dhe magazinimin e informacionit: që me përdorimin e këtyre teknologjive bën që informacioni të mos jetë më ekskluzivisht pronë e një personi. Mund të përmendim këtu stokimin në server-a, të cilët shpesh ndodhen fizikisht jashtë territorit të ndërmarrjes;
- cenueshmëria e informacionit në distancë: që vjen pikërisht si shkak i përdorimit të kësaj teknologjie;
- përdorimi shumë i gjerë i punës në rrjet (network);

*I diplomuar në Business School - Lausanne University Master në drejtësi, kriminalitet dhe siguri të teknologjive të reja, PhD candidate

**Profesor Business School - Lausanne University, Eksperte ndërkombëtare - Unioni Internacional i Telekomunikacioneve

¹ Përdorimi abuziv i Internetit në vendin e punës nga ana e punëmarrësit jashtë kuadrit profesional.



KUJDES NGA «SPIUNËT» NË BIZNES!

Përdorimi i Internetit në vendin e punës, pasojat për biznesin dhe survejimi kompjuterik i vartësve. Përvoja e trajtimit të problemit në Zvicër, në disa vende europiane dhe perspektiva në Shqipëri

• faktin që informacioni dixhital teorikisht nuk ka as origjinal, as kopje, pikërisht falë karakterit të tij numerik. Për këto arsye përdorimi i Internetit nga një ndërmarrje, krahas anëve të mira të tij, sjell dhe një problem të madh pasigurie, përsa i përket informacionit që gjithmonë e më shumë mbart një peshë të madhe në suksesin e biznesit të një ndërmarrjeje.

PASOJAT E ABUZIMIT TË PËRDORIMIT TË INTERNETIT NË NDMARRJE

Fenomeni i 'cyberslacking' është zanafilla e shumë kërcënimeve e rreziqeve të reja për ndërmarrjen. Këto

rreziqe mund të krijojnë probleme në nivelin e produktivitetit, sigurisë së informacionit dhe të ketë një rezultat negativ si për aktivet, ashtu dhe për imazhin e ndërmarrjes. Përdorimi abuziv i Internetit mundet të sjellë si pasojë deri një përfshirje të përgjegjësive së vetë ndërmarrjes si në aspektin civil, ashtu dhe në atë penal. Përsa i përket *kostos*, mund të përmendim koston e lidhjes në Internet. Një kosto, që në vendet perëndimore (ku lidhja bëhet me tarifë fikse), nuk përbën një shumë për t'u marrë në konsideratë. Por me tarifat që praktikohen deri tani në Shqipëri,



ky faktor merr një rëndësi të veçantë. Në lidhje me koston mund të përmendim elektricitetin, koston e printimit de teksteve të ndryshme të shkarkuara nga Interneti, kufizimin e kapacitetit të magazinimit të informacionit etj. Por kostoja më e rëndësishme është ajo që shprehet në kohë pune të pashfrytëzuar. Përdorimi abuziv i Internetit çon kështu në një ngadalësim të funksionimit të kompjuterave, ngarkesë dhe saturim të rrjetit me pasoja të rënda përsa i përket transfertës së të dhënave dhe efikasitetit të veprimeve.

Përsa i përket **sigurisë së informacionit** përdorimi abuziv mund të paraqesë një rrezikshmëri të madhe në raport me sigurinë e resurseve. Konsultimi i faqeve me karakter pornografik, shkëmbimi i 'mail'-ve me burime të pasigurta, rrit ndjeshëm statistikisht ekspozimin ndaj rrezikut. Shpesh faqet dhe mesazhet e kësaj natyre përbëjnë një karrem të mirë për futjen në sistemin informatik të ndërmarrjes së virusëve, krimbave (*worm*), kuajve të Trojës (*Trojan horses*), apo dhe të programeve spiunë në distancë (*spywares, keyloggers*). Pasojat mund të jenë shkatërrimi, modifikimi, vjedhja, përvetësimi i të dhënave, apo dhe marrja e kontrollit të sistemeve të informacionit. Kjo dëmton integritetin, disponueshmërinë dhe sekretin e të dhënave. Komunikimi i adresës 'mail' vend e pa vend, rrit ndjeshëm ekspozimin ndaj fenomenit të *spam-it* (dërgimi i një numri të madh 'mail'-esh). Ky fenomen mund të përdoret për shumë qëllime. Në më të mirën e rasteve, provokon një kosto përsa i përket humbjes së kohës në lexim të

panevojshëm apo në fshirjen e tyre. Në më të keqen e rasteve mund të përdoret si mjet për transmetimin dhe futjen e programeve spiunë, virusëve, krimbave apo kuajve të Trojës, apo dhe ngarkimin e tejskajshëm të rrjetit për të provokuar bllokimin e tij (*denial of service*). Si shembull mund të marrim përhapjen e virusit *Sobig*, i cili shkaktoi dëme, që, sipas përlogaritjeve të bëra, kapin shifrën 500 milion deri në 1 miliard USD². Ky virus u përhap nga një punëmarrës, që kishte shkarkuar imazhe pornografike, nga një *Usenet* në kompjuterin e punës.

DËMTIMI I IMAZHIT TË NDËRMARRJES

Përmbajtja e mesazheve, apo faqeve të konsultuara, mund të ketë pasoja për **imazhin** e ndërmarrjes apo dhe për **përgjegjësinë e saj penale**. Shumë shkelje penale "tradicionale" mund të kryhen nëpërmjet Internetit, biles dhe të lehtësohen nga përdorimi i tij. Ky lehtësim vjen nga anonimiteti, mbrapa të cilit fshihet dhe distanca hapësinore në të cilën vepron kriminelin kibernetik. Shumë nene të kodeve aktuale³ mund të merren në konsideratë për dënimin e veprave penale "tradicionale", të

² Burimi: www.prweb.com/releases/2003/10/prweb83395

³ Në Kodin penal Zviceran flitet për: la représentation de la violence (art. 135), l'escroquerie (art.146), la pornographie (art.197), la discrimination raciale (art.261bis) ainsi que les délits contre l'honneur (art.173 ss).

kryera nëpërmjet Internetit. Mund të përmendim këtu pornografinë (neni 117 i Kodit Penal Shqiptar KPSH), Fyerja (neni 119 KPSH), Shpifja (neni 120 KPSH), Përhapja e sekreteve vetjake (neni 122 KPSH), Pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës (neni 123 KPSH), Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit (neni 149 KPSH), Zhdukja dhe vjedhja e dokumenteve (neni 192/a KPSH), Thirrjet publike për veprime të dhunshme (neni 223 KPSH), Shpërndarja e shkrimeve antikushtetuese (neni 225 KPSH), Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve (neni 265 KPSH), Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik (neni 267 KPSH), Njoftim i rremë në organet e rendit (neni 272 KPSH), Pastrimi i parave të pista (neni 287/a KPSH). Diçka pozitive është dhe fakti që "krimi kompjuterik" i mirëfilltë dënohet penalisht si i tillë. Kodi Penal Shqiptar në nenin 192/b përcakton që: *ndërhyrja në çdo formë, në transmetimet dhe programet kompjuterike, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet...* Të mos harrojmë faktin që Shqipëria është nënshkruese e Konventës "Për krimin në fushën e kibernetikës" në Budapest më 23 nëntor 2001, konventë të cilën ajo e ka ratifikuar.

RREZIQT PËR PUNËDHËNËSIN

Po cili është rreziku për punëdhënësin në këtë rast? Së pari, siç e theksuam edhe më lart, rreziku më i madh ka të bëjë me imazhin e ndërmarrjes. Natyrisht një ndërmarrje, vartësit e së cilës thejnë ligjin, nuk do të ishte një reklamë e mirë për ndërmarrjen. Për legjislacionin zvicerian neni 55⁴ i Kodit të Obligacioneve parashikon gjithashtu një përfshirje të përgjegjësive së ndërmarrjes në rast se punëdhënësi nuk ka marrë të gjitha masat, që diçka e tillë të mos ndodhte. Kjo procedurë ndiqet edhe në legjislacionin francez, amerikan, anglez, belg dhe holandez, ku ndërmarrja mund të mbartë përgjegjësi për

aktet e kryera nga vartësit, pikërisht duke pasur parasysh që punëmarrësi ka për detyrë të bëjë kujdes që këto

⁴ L'employeur est responsable du dommage causé par ses travailleurs ou ses autres auxiliaires dans l'accomplissement de leur travail, s'il ne prouve qu'il a pris tous les soins commandés par les circonstances pour détourner un dommage de ce genre ou que sa diligence n'eût pas empêché le dommage de se produire (Punëdhënësi është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga punëmarrësit e tij apo nga ndihmës të tjerë në përmushjen e punës së tyre , në qoftë se ai nuk vërteton që ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të evituar këtë lloj dëmi dhe që kujdesi i tij nuk ka mundur ta parandalojë dëmin).

gjera të mos ndodhin. Në legjislacionin shqiptar, për momentin, asnjë dispozitë nuk ndëshkon direkt punëdhënësit për veprimet penale të vartësve të tij, por kjo nuk e liron nga detyrimi i "trajnitimit" dhe i vënies në dijeni, që ai ka për vartësit e vet.

PËRDORIMI I INTERNETIT NË VENDIN E PUNËS, TRAJTIMI LIGJOR I PROBLEMIT

Ashtu si dhe një përdorues i zakonshëm, një vartës mund të përdorë aplikacione të ndryshme, që prekin sferën e Internetit, të cilat mund t'i klasifikojmë në dy kategori:

- atë të regjistrimit të të dhënave (*downloads, e-mails* etj.);
- atë të navigimit në Internet, apo pjesëmarrjes nëpër forume, *chat* etj.

Në kuadrin e aktivitetit të tij profesional, punëmarrësi mundet dhe duhet të bëjë një përdorim profesional të pajisjeve dhe materialeve që punëdhënësi i vë në dispozicion. Me termin përdorim profesional nënkuptojmë përdorimin e pajisjeve dhe materialeve në kuadrin e përbushjes së detyrës, që mund të rrjedhë ose nga një kërkesë direkte e punëdhënësit, ose thjesht nga fakti dhe detyrimi që ka një punëmarrës të përbushë misionin, i cili i është caktuar. Duke ndjekur këtë logjikë, një përdorim që del nga kjo kornizë, mund të konsiderohet si një përdorim jo-profesional.

Në marrëdhënien punëdhënës-punëmarrës, ky i fundit ka një detyrim moral dhe kontraktual bindje, kujdesi në punë dhe besnikëri, përballë punëdhënësit. Këtë detyrim, që rrjedh nga neni 321a⁵

i Kodit të Obligacioneve zviceran, e gjejmë dhe në nenin 24 të Kodit Shqiptar të Punës, të formuluar në një mënyrë pothuajse identike. Ky nen përcakton që: *punëmarrësi kryen me kujdes punën që i ngarkohet dhe që punëmarrësi për kryerjen e punës duhet të përdorë sipas rregullave të caktuara mjetet e punës, aparaturat, mjetet e punëdhënësit dhe pajisjet e vëna në dispozicion të tij.* Kështu, mund të nxjerrim përfundimin se punëmarrësi, përveç rastit të një marrëveshjeje të posaçme, nuk duhet dhe nuk mundet të përdorë pajisjet teknike, telefonike dhe elektronike, të vëna në dispozicion

⁵ ... utiliser selon les règles en la matière les machines, les instruments de travail, les appareils et les installations techniques (përdorimin sipas rregullave të makinerive, instrumenteve të punës, aparateve dhe instalimeve teknike)... et de les traiter avec soin, de même que le matériel mis à sa disposition pour l'exécution de son travail. (dhe t'i trajtojë me kujdes, ashtu si dhe materialet e vëna në dispozicion për përbushjen e punës)


nga punëdhënësi, jashtë përdorimit profesional. Në Zvicër, ashtu si dhe në shumicën e vendeve europiane, mungon një legjislacion i veçantë për këtë temë. Organizma qeveritarë ose jo-qeveritarë mundohen të publikojnë rregullore, rekomandime etj., por këto të fundit ngelen gjithmonë në një kuadër të ligjeve të buta, që do të thotë pa asnjë forcë detyruese. Nisur nga kjo situatë legjislative dhe për të zgjidhur problemet e kësaj natyre, që ekzistojnë realisht në jetën e përditshme, duhet t'i kthehemi ligjeve në fuqi.

Në qoftë se i referohemi nenit 319⁶ të Kodit të Obligacioneve të Zvicrës, ashtu si dhe nenit 26 paragrafi 3 të Kodit Shqiptar të Punës përcaktohet se: *gjatë vlefshmërisë së kontratës, punëmarrësi nuk duhet të kryejë asnjë punë të paguar nga të tretët, e cila dëmton punëdhënësin ose i bën konkurrencë atij.* Ideja është pothuajse e njëjtë, përveç faktit që në kodin zviceran formulimi bëhet në një mënyrë pozitive, ku flitet se, punëmarrësi gjatë vlefshmërisë së kontratës duhet të vihet totalisht në shërbim të punëdhënësit. Nisur nga këto formulime mund të nxjerrim përfundimin që në qoftë se punëmarrësi kalon kohën duke luajtur me letra në ordinator, atëherë është në kundërshtim të plotë me Kodin e Punës dhe me marrëdhëniet kontraktuale me punëdhënësin dhe si rrjedhojë, duhet të mbartë pasojat.

Jurisprudenca na jep gjithashtu një ndihmë të çmuar në trajtimin e problemit. Gjykata Federale e Zvicrës⁷ konsideron se vetëm përdorimi për qëllime private, që merr përmasa të konsiderueshme, mund të sanksionohet me një heqje nga puna me efekt të menjëhershëm. Ndërsa një përdorim i

⁶ ... le travailleur s'engage, pour une durée déterminée ou indéterminée, à travailler au service de l'employeur (punonjësi angazhohet për kohë të caktuar apo të pacaktuar për të punuar në shërbim të punëdhënësit)

⁷ Ekuivalente e Gjykatës së Lartë në Shqipëri




kufizuar mund të tolerohet në një farë mënyre dhe të sanksionohet vetëm në rastin kur punëmarrësi është vënë në dijeni më përpara nga punëdhënësi. Në qoftë se përdorimi i Internetit për qëllime private tolerohet nga punëdhënësi, atëherë mund të nxjerrim përfundimin që ky përdorim është i lejueshëm për ndërmarrjen në fjalë. Ideja mbrapa kësaj logjike të jurisprudencës mbetet moscenimi i të drejtave themelore të njeriut siç është dhe ajo e të drejtës për të qenë i informuar.

Deri tani kemi folur për përdorimin e Internetit dhe të teknologjive të reja në përgjithësi brenda orëve të punës. Po ç'ndodh nëse të njëjtin aktivitet punëmarrësi do ta kryente gjatë pushimeve ditore që i takojnë me ligj⁸? Kohën e pushimit ditor normalisht punëmarrësi mund ta kalojë sipas vullnetit të tij të lirë duke përfshirë këtu dhe navigimin apo përdorimin e pajisjeve të vëna në dispozicion nga punëmarrësi, por kjo gjë me kusht që veprimtaria e tij të mos paraqesë as më të voglin rrezik për imazhin, emrin apo sigurinë e të dhënave të ndërmarrjes.

VËZHGIMI KOMPJUTERIK I VARTËSVE

'Cyberslacking' përbën një rrezik për gjithë ndërmarrjen në planin strategjik, ekonomik, ligjor dhe financiar. Për të ruajtur mbarëvajtjen dhe jetëgjatësinë e ndërmarrjes, duhet në radhë të parë të kuptohet rëndësia, ekspozimi dhe kostot sipas rastit të rrezikut. Kështu, mund të merren masat e duhura për të kufizuar mundësinë që ky rrezik të ndodh realisht. Administrimi i rrezikut, që lidhet me 'cyberslacking', është në origjinë të asaj që quajmë vëzhgim kompjuterik, që është përgjigjja teknologjike ndaj këtij rreziku. Vëzhgimi kompjuterik është çdo mjet kontrolli teknologjik ndaj një personi apo procesi, që lidhet me teknologjitë e

⁸ Neni 79 i Kodit të Punës Shqiptar.



reja dhe veçanërisht me rrjetet dixhitale (networks) të komunikimit. Survejimi kompjuterik mund të bëhet nëpërmjet:

- analizës së skedarëve (file) të historikut, të skedarëve të regjistrimit (logfiles) për të pasur një ide jo shumë të detajuar të aktivitetit të përdoruesit të kompjuterit (çfarë skedarësh ka hapur e konsultuar, të çfarë lloji, në ç'kohë, detaje mbi përdorimin e faqeve të internetit, llojin, adresën, orën e konsultimit, kohëzgjatjen etj.;
- në qoftë se ndërmarrja ka një sistem Intranet-i, përgjigjet e pyetjeve të mësipërme janë shumë më të detajuara;
- mjeteve ndërlidhëse në rrjet të stilit router, firewall, të cilët memorizojnë adresat IP dhe aktivitetin e tyre;
- mjeteve dhe programeve të kontrollit në distancë të përdorura nga administratorët e rrjetit;
- programeve spiunë të stilit spywares, keyloggers, që regjistrojnë gjithë aktivitetin e kompjuterit dhe të çdo pajisjeje që është e lidhur me të.
- Content scanners, të cilët fotografojnë përmbajtjen e ekranit dhe sipas përmbajtjes mundën ta fshijnë, ta bllokojnë apo të dërgojnë automatikisht një kopje administratorit të sistemit.

DERI KU MUND TË ARRIJË SURVEJIMI KOMPJUTERIK

Por fakti më i rëndësishëm nuk është se si të survejojmë, por deri ku mundemi të shkojmë me survejimin kompjuterik, çfarë të dhënash mundemi të mbledhim dhe a mundemi apo jo.

Siç e theksuam edhe më sipër, si Kodi i Obligacioneve zvicerian, ashtu dhe Kodi i Punës Shqiptar i japin të drejtën punëdhënësit t'i japë direktiva dhe detyra punëmarrësit. Ky fakt i jep në të njëjtën kohë dhe të drejtën për të kontrolluar nëse punëmarrësi i ka përmbushur këto detyra. Në qoftë se i referohemi kësaj logjike, atëherë

survejimi kompjuterik nuk është i dënueshëm në parim. Megjithatë mbetet të përcaktohen "masat më të drejta" (një e mesme), që të mos preken interesat e askujt. Në një akt nënligjor mbi të drejtën e punës, qeveria zvicerane i ndalon kategorikisht punëdhënësit të kryejë një survejim individual. Dhe në qoftë se megjithatë do të duhen sisteme survejimi për një arsye apo për një tjetër, atëherë ato duhet të ndërtohen në një mënyrë të tillë që të mos çenojnë lirinë themelore të vartësit, atë të jetës së tij private. Në këtë kontekst survejimi i navigimit të Internetit dhe leximi i 'mail'-ve të vartësit nga ana e punëdhënësit nuk janë të pranueshëm. Për këtë arsye keyloggers, spywares dhe content scanners nuk lejohen kategorikisht nga ligji zviceran, ai evropian, por as nga ai shqiptar. Në nenin 33 të Kodit të Punës shqiptar përcakton se: *Punëdhënësi, gjatë mardhënëve të punës, nuk duhet të mbledhë informata lidhur me punëmarrësin, përveç rasteve, kur këto informata lidhen me aftësitë profesionale ose janë të nevojshme për zbatimin e kontratës.* Për më shumë, që neni 121⁹ i Kodit Penal Shqiptar dënon ndërhyrjen e padrejtë në jetën private. Në krahun tjetër, ligji zviceran lejon analizën anonime duke përdorur pseudonime, të skedarëve (file) të historikut. Punëdhënësi mund të nisë një hetim më individual vetëm pas një informacioni paraprak dhe në prani të një konstatimi të keqpërdorimit nga ana e një punëmarrësi. Megjithatë, një zgjidhje ideale nuk ekziston. Për çdo rast duhen peshuar mirë interesat e të dyja palëve. Si në çdo aspekt tjetër, masat parandaluese, duke vënë në dijeni të interesuarit, ngelen strategjia më e mirë për të ruajtur ekuilibrat. Si shembull të këtyre masave parandaluese mund të marrim:

- Instalimin e antiviruseve;
- Ndalimin automatik të hapjes së 'e-mail'-ve nga një prejardhje e dyshimtë (jo të njohur nga sistemi);
- Përdorimi i filtrave që ndalojnë navigimin nëpër URL¹⁰, që mund të jenë burim problemesh;
- Bllokimin e disa llojeve file-sh si për shembull .exe, .mp3 etj.
- Ndalimin automatik të pjesëmarrjes nëpër forume, chat etj.

Përveç ligjeve të përmendur më sipër, një tjetër mjet për të studiuar ligjshmërinë e survejimit kompjuterik është dhe Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në këtë pikë kemi një përputhje totale të ligjit shqiptar me

atë zviceran dhe evropian. Në nenin 5 të ligjit në fjalë, ashtu siç përcaktohet edhe në nenin 4 të ligjit zviceran, mund të gjejmë elemente përgjigjeje për sa i përket mbledhjes së të dhënave nga punëdhënësi si për shembull:

- Trajtimi i të dhënave personale bëhet:
- me një qëllim të përcaktuar, të qartë dhe legjitim;
- në mënyrë të saktë dhe mbi bazën e të dhënave të përditësuara;
- pa e tejkuluar qëllimin për të cilin ato trajtohen dhe jo për më shumë kohë nga ç'është e nevojshme për realizimin e qëllimit të trajtimit;
- ... duke përdorur vetëm ato të dhëna që kanë rëndësi dhe që janë të nevojshme për realizimin e qëllimit të trajtimit.

Për më shumë nenet 12 dhe 13 i japin të drejtën punëmarrësit, për t'u njohur me të dhënat personale që punëmarrësi mbledh për të dhe për të kundërshtuar trajtimin.

THEMBRA E AKILIT

Thembra e "Akilit" mbetet gjithmonë pyetja nëse përmbajtjet e 'e-mail'-ve mund të survejohen apo jo. Këtu përvojat dhe zgjidhjet janë të shumëllojshme. Kalojmë nga një ndalim kategorik i survejimit në Francë, në një kontroll vetëm pas pëlqimit paraprak të punëmarrësit apo vetëm në raste të veçanta në Belgjikë për të arritur në një lejim pa kufi, siç është rasti i Anglisë. Për mendimin tonë kjo çështje duhet trajtuar sipas përdorimit që punëdhënësi i lejon punëmarrësit. Në rast se përdorimi privat është kategorikisht i ndaluar dhe i komunikuar, atëherë mund të imagjinojmë lejimin e një kontrolli mbi përmbajtjen e 'e-mail'-ve. Por në më të shumtën e rasteve punëdhënësit nuk kanë një qëndrim të prerë për këtë problem. Në një situatë të tillë kontrolli duhet të jetë vetëm në rast se kemi të dhëna që abuzimi ekziston. Për sa i përket 'cyber-survejimit' të vartësve mund të evidentojmë tre parime bazë:

- Informimin paraprak;
- Transparençë në marrëdhëniet kontraktuale;
- Përdorimin e të dhënave që kanë rëndësi dhe që janë të nevojshme, pa e tejkuluar qëllimin për të cilin ato trajtohen.

Origjina e konfliktit 'cyberslacking'-survejim kompjuterik qëndron në faktin se zgjidhja që duhet t'i jepet problemit, nuk është vetëm juridike apo vetëm teknologjike. Zgjidhja ideale dhe më e drejta do të ishte ajo që do të gërshetonte teknologjiken me ligjoren në një procedurë të mirëfilltë administrimi ekstraprofesionale. Duhet marrë në konsideratë të tre aspektet e mbarëvajtjes së ndërmarrjes, aspektit administrues, organizues dhe njerëzor, për të siguruar kështu respektin e të drejtave të punëdhënësit dhe të punëmarrësit së bashku. ■

⁹ Vendosja e aparaturave që shërbejnë për dëgjim apo regjistrim të fjalëve apo të figurave, dëgjimi, regjistrimi ose transmetimi i fjalëve, fiksimit, regjistrimi ose transmetimi i figurave si dhe ruajtja për publikim apo publikimi i këtyre të dhënave që ekspozojnë një aspekt të jetës private të personit pa pëlqimin e tij, përbën kundërvajtje penale...

¹⁰ Uniform Resource Locator.